



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**  
**DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLIGJISË SË TREGJEVE**

**NJOFTIM**

**Rasti:** Rasti i përfimit të kontrollit të shoqërisë DELGI SHPK nga shoqëria SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA SHPK.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 411 prot. i AK, datë 19.07.2023 “Saint-Gobain Construction Products Albania SHPK / Delgi SHPK”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me përfitim e kontrollit të shoqërisë DELGI SHPK nga shoqëria SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA SHPK.

Referuar dokumentit “Marrëveshje shitblerje kuotash për shit-blerjen e 100% të kuotave në Delgi SHPK”, palët janë:

**SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA SHPK** (Saint-Gobain SHPK) është një shoqëri më përgjegjësi të kufizuar, i themeluar sipas legjislacionit shqiptarë, e cila ka si objekt aktiviteti prodhimin, shpërndarjen dhe /ose tregtimin e materialeve të ndërtimit, si dhe transportin ndërkombëtar të mallrave.

Shoqëria Saint-Gobain SHPK zotërohet tërësisht nga shoqëria Saint- Gobain Produits Pour La Construction, e cila kontrollohet nga shoqëria Compagnie De Saint- Gobain, shoqëria mëmë e grupit Saint-Gobain.

**Shoqëria Target: DELGI SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptarë. Shoqëria ushtron aktivitetin në fushën e shfrytëzimit të mineraleve të grupeve 1,2,3,4; projektim dhe ndërtim minierash dhe karierash, prodhimin e lëndëve të para të ndërtimit, konsulencë, import eksport materialesh dhe pajisje për minierat e karrierat, transport nacional dhe internacional të mallrave etj.

**Pala shitëse:** Tre individë, shtetas shqiptar.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim e kontrollit të shoqërisë DELGI SHPK nga shoqëria SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA SHPK.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**